



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 204, datë 20.05.2021**

**PËR**  
**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}**  
**DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATAT**  
**E APELIT DURRËS DHE TIRANË, PËR POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË**  
**DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 392, NR. 394 DHE NR. 395,**  
**DATË 07.10.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Ilir Toska,

**VENDOSI:**

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës dhe Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 392, nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020.
2. Vendimi nr. 624, datë 10.12.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**